

**STATUT I SHOQËRISË**  
**“ONE SOLAR” shpk.**

Ky Statut do të konsiderohet se **inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë**, organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, më **20 /02 / 2024**, ne:

1. **Altin Hoxha**, atësia Shezai, amësia Bukurie, shtetas Shqiptar, lindur në Kuçovë dhe banues në Tiranë, me adresë: Merdar Shtylla, Nd. 30, h. 2, Ap. 50, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, lindur më 20/02/1970, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038784308 dhe nr. personal H00220257E;
2. **Enriko Lena**, atësia File, amësia Shaqe, shtetas Shqiptar, lindur në Gramsh dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga Teodor Keko, Nd. 1, H. 1, Njësia Administrative Nr. 6, 1027, Tiranë, lindur më 03/12/1978, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaportën nr. BF2744245 dhe nr. personal H81203048P,

në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, vendosem të miratojmë këtë Statut si vijon:

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë.

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më **20 / 02 / 2024**, ne, themeluesit e mësipërm, themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar “**ONE SOLAR**” shpk.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Aplikimi, projektimi, implementimi, ndërtimi, menaxhimi, mirëmbajtja dhe operimi i objekteve/centraleve/parqeve të prodhimit të energjisë elektrike nga energjia diellore, eolike, hidrike. Import, eksport, tregtim i paneleve fotovoltaike si dhe materialeve ndërtimore që lidhen me ndërtimin e parqeve fotovoltaike, eolike, hidrike. Prodhimi i energjisë elektrike nga Burime të Rinovueshme të Energjisë. Tregtimi dhe furnizimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike ndaj të tretëve, përfshirë konsumatorët fundorë, subjektet private, tregtarët dhe furnizuesit e ndryshëm të energjisë elektrike brenda dhe jashtë vendit sipas legjislacionit shqiptar të aplikueshëm në fuqi nëpërmjet kontratave bilaterale apo çdo lloj kontrate të aplikueshme. Shitja dhe blerja e energjisë elektrike në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) apo në bursa të tjera jashtë vendit (rajonale apo evropiane). Dhënia, marrja me qira, shitje-blerje e tokave për zhvillimin



parqeve fotovoltaike, eolike apo hidrike. Aplikimi dhe marrja nga qeveria shqiptare apo institucionet përgjegjëse të shtetit shqiptar i të gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Zbatim, projektim të ndërtimeve civile, ekonomike, punime dheu, sistemim taracime, prodhime elementesh të parafabrikuara, betoni e beton arme, ndërtime civile e turistike, rrugësh, vepra arti, hekurudha e kanalizime, punime karperterie. Çdo aktivitet tjetër që lidhet në mënyrë direkte dhe indirekte dhe që i shërben përmbushjes së aktiviteteve si më lart.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e **pacaktuar dhe/ose e pakufizuar**.

### **Neni 4 Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë, Tiranë, Rruga "Komuna Parisit", Nr. Pasurie 6/284-N14, Zona Kadastrale 8260, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri.

Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

### **Kreu II Kapitali**

#### **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është ALL 100.000,00 (njëqind mijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Altin Hoxha**: Zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme ALL 50.000,00 që përbën **50% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.
2. Ortaku themelues **Enriko Lena**: Zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme ALL 50.000,00 që përbën **50% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.

Kontributi i ortakëve është në para dhe do të shlyhet prej tyre menjëherë me themelimin e shoqërisë. Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij.

#### **Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe të shoqëritë kontrolluese dhe/ose te grupit të caktuar me vendimin e Asamblesë. Pjesët e kapitalit mund të kalohen te të tretët vetëm me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, që jepet nëpërmjet një vendimi të marë me unanimitet. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

#### **Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një here në vit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të thirret nga Administratorët dhe, kur është e zbatueshme, nga Ortakët.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të dërgohet me shkrim apo e-mail në adresat që secili Ortak do t'i njoftojë me shkrim Shoqërisë me postë të regjistruar. Njoftimi do të konsiderohet se i është dorëzuar Shoqërisë me kalimin e ditës së 7-të pas dërgimit.

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përcaktojë qartë emrin e Shoqërisë, selinë, datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, një përshkrim të hollësishëm të procedurës që duhet të ndiqet nga Ortakët për pjesëmarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e mënyrën e marrjes së dokumenteve dhe projektvendimeve që duhet t'u vihen në dispozicion të gjithë Ortakëve, po ashtu edhe rendin e ditës, dhe duhet t'u njoftohet Ortakëve të paktën 7 (shtatë) dite para mbledhjes. Rendi i ditës i njoftuar si më sipër duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për ndryshime të Statutit, teksti përkatës duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet e komunikimit elektronik, që garantojnë identifikimin e ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehën për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Një Ortak mund të përfaqësohet në Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë i ndryshëm nga Administratorët, duke paraqitur dokumentin përkatës autorizues. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

## **Neni 10 Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 80 (tetedhete) përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11 Marrja e vendimeve**



Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 12

### Përgjithshmi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- **Z. Altin Hoxha**, atësia Shezai, amësia Bukurie, shtetas Shqiptar, lindur në Kuçovë dhe banues në Tiranë, me adresë: Merdar Shtylla, Nd. 30, h. 2, Ap. 50, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, lindur më 20/02/1970, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038784308 dhe nr. personal H00220257E, nr. kontakti: +355692121195, pa kufizime në kompetencat e administrimit.

## Neni 14

### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastiit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si

dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkëlja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV** **Viti financiar-ekspertet**

##### **Neni 16** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 17** **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë, i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Kreu V** **Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

##### **Neni 18** **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve;



c) me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 19**

#### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


#### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortakët themelues si vijon:

**ORTAKËT THEMELUES  
TË SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“ONE SOLAR” shpk.**

Altin Hoxho 

ENRIKO LEVA 